



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 277, Datë 27.10.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BIGWIND” SH.P.K.,  
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI  
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, ME VENDNDODHJE NË  
FSHATIN DARZEZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/9 prot., datë 24.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “BIGWIND” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815 prot., datë 13.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali “Fotovoltaik”, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier”.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha

aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “BIGWIND” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”, pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c” si dhe pikën 2.1, gërmat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

#### *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitet për administratorin të lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi, si dhe dëshminë e penalitetit për shoqërinë “BIGWIND” sh.p.k.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi stafin teknik që do të në funksion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

#### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE letrën e referencës të lëshuar nga banka.

#### *Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës*

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të specifikojë tipin e centralit Fotovoltaik (off-shore, on-shore apo tjetër).
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaik është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**